17	Pjesëmarrëse në promovimin e librit “Konflikti i vitit 2001” 10 dhjetor 2021, Universiteti i Tetovës	0.5
18	Reportere nga Maqedonia e Veriut, në Radion shtetërore Australiane, SBS -RADIO, 12 vite	1
19	Themeluese dhe mësimdhënëse e shkollës “Ardhmëria” Decan (2018-2020)	1,5x2=3
20	Themeluese dhe mesimdhënëse në shkollën private “Kult Kërçovë (2018-2020)	1.5x2 =3
	Gjithsej	28

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN	Poenët
VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE	92.3
VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE	45.5
VEPRIMTARIA PROFESIONALE-ARTISTIKE	88.1
VEPRIMTARIA APLIKATIVE-PROFESIONALE	33.5
VEPRIMTARIA ME INTERES TË GJERË PUBLIK	28
Gjithsej	287.4

Tetovë, 01.06.2023

KOMISIONI RECENSUES

Anëtarët e komisionit

Prof. Ord. Zana Shuteriqi Prela- kryetare

Prof. Ord. Slavica Petrovska Galic-anetare

Prof. Ord. Arifikmet Xhemaili-anetar

KËSHILLIT TË REKTORATIT TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS

REFERAT

Për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Metodika e edukatës figurative, Pikturë dhe teknika të pikturës (60708, 60701 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit),

Programin studimor - Art figurativ, në

Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës.

Në bazë të konkursit të datës 06.05.2023, të shpallur në gazetata ditore „Koha” dhe „Sloboden pečat”, si dhe në web faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, www.unite.edu.mk, për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin **Metodika e edukatës figurative, Pikturë dhe teknika të pikturës (60708, 60701 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**, në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës me Vendim të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Arteve nr.20-84/4 të datës 22.05.2023, formohet Komisioni recensues në përbërje:

1. Prof. Dr. Fehim Husković, (kryetar), profesor ordinar, Universiteti “Kirili dhe Metodi” Shkup,
2. Prof. Mr. Reshat Ahmeti,(anëtar), profesor ordinar, në Fakultetin e Arteve, Universitetit i Tetovës,
3. Prof. Mr. Bashkim Mexhiti, (anëtar), profesor ordinar në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës

Sipas dokumentacionit të paraqitur nga kandidati: **Profesor inordinar, Dr. Lulzime Leka – Mulaku** (e cila është kandidatja e vetme e paraqitur), për zgjedhjen e mësimdhënësit ne thirrjen ***Profesor ordinar*** për lëndët e shpallura në konkurs:

- METODIKË E EDUKATËS FIGURATIVE
- PIKTURË DHE TEKNIKA TË PIKTURËS

Komisioni recensues, duke qenë falënderues për besimin e dhënë ka nderin të paraqesë këtë:

R A P O R T

Në konkursin që Këshilli i Rektoratit i Universitetit të Tetovës ka shpallur më datë 06.05.2023, për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët mësimore:

- METODIKË E EDUKATËS FIGURATIVE
- PIKTURË DHE TEKNIKA TË PIKTURËS

PROGRAMI STUDIMOR: Art figurativ; Fakulteti i Arteve; Universiteti i Tetovës.

Në konkurs është paraqitur kandidatja **Profesor inordinar, Dr. Lulzime Leka - Mulaku.**

Duke u bazuar në dokumentacionin e parashtruar të kandidates, komisioni recensues jep këto konstatime dhe vlerësime:

TË DHËNA BIOGRAFIKE

E lindur më 07.07.1966 në Shkup.

Arsimimin e mesëm e mbaroi në Gjimnazin e Tetovës.

Studimet e larta i mbaroi më 1985 në Universitetin e Prishtinës, në Akademinë e Arteve - Dega e Pikturës, në klasën e Akademik, Prof. Rexhep Ferrit, duke e arritur titullin Piktore Akademike.

Në vitin shkollor 2000/2001 regjistrohet në shkallën e tretë të studimeve pranë Universitetit të Prishtinës, Drejtimi i Pikturës. Të njëjtin e mbaron në vitin 2004, me mbrojtjen e suksesshme të tezës së magjistraturës “Gruaja për Gruan”, me mentor prof. Rexhep Ferrin, duke e arritur titullin Magjistre e Pikturës. Në vitin shkollor 2009/2010 regjistrohet në studimet e doktoratës të cilat i përfundon më 2012/2013 duke e mbrojtur me sukses punimin e disertacionit “Ndikimet e materialeve dhe teknikave në kreativitetin e të shprehurit figurative të fëmijëve nga klasa e V deri në të VIII”, me Mentor, Prof. Dr. Fehim Husković.

Më 2012, zgjedhet në thirrjen mësimore-shkencore, **Docent** për lëndët mësimore Metodikë e Artit Figurativ 1 dhe 2, Pikturë në drejtime 1 dhe 3, në Fakultetin e Arteve , Artet Figurative në Universitetin e Tetovës.

Më 2018, zgjedhet në thirrjen mësimore-shkencore, **Profesor inordinar** për lëndët mësimore Metodikë e Artit Figurativ 1 dhe 2, Pikturë në drejtime 1 dhe 3, në Fakultetin e Arteve, Artet Figurative në Universitetin e Tetovës.

PËRVOJA PROFESIONALE

Angazhimet në arsim:

- Gjashtë vite në arsimimin fillor si mësimdhënëse e lëndës së Artit Figurativ,
 - Shkolla Fillore “Kiril Pejçinoviç”, Tearcë, 1988 - 1990
 - Shkolla Fillore “Fan Noli”, Trebosh, 1990 - 1992
 - Shkolla Fillore “Gjergj Kastrioti - Skënderbeu”, Poroj, 1992 - 1994

- Shtatë vite në arsimimin e mesëm si mësimdhënëse e lëndës së Artit Figurativ,
 - Shkolla e Mesme Ekonomike “8 Shtatori”, Tetovë
 - Shkolla e Mesme e Mjekësisë “Nikolla Shtejn”, Tetovë
 - Gjumnazi i Tetovës “Kiril Pejçinoviç”, Tetovë

- Nëntëmbëdhjetë vite e inkuadruar në **Universitetin e Tetovës, Fakulteti i Arteve**, si mësimdhënëse – Asistente (vitet 2004 – 2012), mësimdhënëse – Docente (vitet 2013 – 2017), mësimdhënëse – Prof. inordinar (vitet 2018 – 2023)
 - Mësimdhënëse – Asistente e lëndës *Metodikë e Artit Figurativ*, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Fakulteti i Arteve, vitet 2004 – 2012,
 - Mësimdhënëse – Asistente e lëndës *Metodikë e Artit Figurativ*, Universiteti i Tetovës, Fakulteti Pedagogjik, viti shkollor 2004/2005,
 - Mësimdhënëse – Asistente e lëndës *Teoria e Hapësirës*, Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Arteve, viti 2004/2005
 - Asistente në lëndën *Akt i Mbrëmjes*, Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Arteve, 2006/2007,
 - Asistente në lëndën e *Pikturës*, Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Arteve, në drejtimin e Pikturës, 2008/2012
 - Asistente në lëndën e *Pikturës*, Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Arteve, në drejtimin e Dizajnit, 2008/2012

- Asistente në lëndën e *Pikturës*, Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Arteve, në drejtimin Skulpturës 2008/2012.
- Mësimdhënëse – Docente e lëndës *Metodikë e Artit Figurativ 1 dhe 2*, Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Arteve, vitet 2012 – 2018,
- Mësimdhënëse – Docente e lëndës *Art Konceptual 1 dhe 2*, Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Arteve, vitet 2012 – 2018,
- Mësimdhënëse – Docente e lëndës *Piktura 2*, Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Arteve, drejtimi i Grafikes, Skulpturës, vitet 2017/2018.
- *Mësimdhënëse – Prof. inordinar e lëndës Metodikë e Artit Figurativ 1 dhe 2, Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Arteve, vitet 2018/2023,*
- *Mësimdhënëse - Prof. inordinar e lëndës Art Konceptual 1 dhe 2, Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Arteve, vitet 2018/2023,*
- *Mësimdhënëse –Prof. inordinar e lëndës Piktura në drejtime 1 dhe 2, Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Arteve, drejtimi i Grafikës, Skulpturës, vitet 2018/2023.*

KRIJIMTARIJA ARTISTIKE

- Pjesëmarrje në më tepër se gjashtëdhjetë ekspozita kolektive të punimeve të pikturës, brenda dhe jashtë vendit:

- Kosovë, disa ekspozita, vitet 1984 – 1987,
- Tetovë, Kafe – Galeri “Dora”, 1992
- Shqipëri, Tiranë, Galeria Nacionale e Arteve, Ekspozita Gjithëkombëtare e Artistëve Figurativ, viti 1993,
- Tetovë, Shkolla e Mesme e Muzikës “Todor Skallovski”, 1994,
- Kolonija ndërkombëtare e piktorëve, Tetovë 2002,
- Berat, Galeria e Arteve “Eduard Lir”, Ekspozita Gjithëkombëtare e Artistëve Figurativ, viti 2009,

- Maqedoni, Tetovë, Salloni Pranveror, ekspozitat e Shoqatës së Krijuesve, vitet 1996 – 2010, etj.
- Maqedoni, Tetovë, Salloni Dimëror, ekspozitat e Shoqatës së Krijuesve, vitet 1996 – 2010, etj.
- Tetovë, 4 Korrik, Ekspozitë e organizuar me rastin e ditës së pavarësisë së SHBA, 2010
- Tetovë, Galeria e Arteve, Ekspozitë e femrave krijuese me rastin e Ditës së Mësuesit dhe Ditës së Gruas, 2009
- Tetovë, Galeria e Arteve, Ekspozitë e femrave krijuese me rastin e Ditës së Mësuesit dhe Ditës së Gruas, 2010
- Tetovë, Galeria e Arteve, Ekspozitë e femrave krijuese me rastin e Ditës së Mësuesit dhe Ditës së Gruas, 2011
- Shkup, Libraria - Galeria
- Shkup, Muzeu Daut Pasha, ekspozitë e mësimdhënësve të Fakultetit të Arteve të USHT – së, 2012,
- Ekspozitat vjetore të rregullta të mësimdhënësve të Fakultetit të Arteve 2013 – 2017.
- Ekspozitat vjetore të Shoqatës së Artistëve të Tetovës, 2012-2017
- ***Ekspozitat vjetore të rregullta të mësimdhënësve të Fakultetit të Arteve 2018 – 2023.***
- ***Ekspozitat vjetore të Shoqatës së Artistëve të Tetovës, 2018-2023***
- ***Ekspozita kolektive ndërkombëtare, Simpozium ndërkombëtar artistik, Strugë 2019***
- ***Ekspozita kolektive ndërkombëtare, Simpozium ndërkombëtar artistik, Tetovë 2020,***
- ***Ekspozita kolektive ndërkombëtare, Simpozium ndërkombëtar artistik, Pogradec 2022.***

- Ekspozitat personale:

- Galeria e Arteve Tetovë, ekspozita “Kush e solli Doruntinën” cikli i parë, viti 2008,
- Galeria e Arteve Tetovë, ekspozita “Kush e solli Doruntinën” cikli i dytë, viti 2010,

- Galeria kombëtare “Mala Stanica” në Shkup, viti 2011,
- Kosovë, Ekspozitë personale me rastin e manifestimeve të kremtimit të 100 Vjetorit të Pavarësisë, viti 2012.
- Kosovë, Ministria e Kulturës së Republikës së Kosovës, Galeria e Arteve, ekspozita personale Metamorfoza e Kujtesës, viti 2016,
- *USA, Nju Jork, Galeria e QKI, Maj 2018,*
- *Bursa, Republika e Turqisë, Galeria e qytetit, Maj 2021,*
- *Pogradec, Republika e Shqipërisë, Galeria e qytetit, Shtator 2022.*

PUBLIKIMET SHKENCORE:

- TAKIMI I VII VJETOR SHKENCOR NDËRKOMBËTAR IASH 2012, Shkup, 29 – 31 Gusht 2012,
- Punimi, kumtesa: “Artet Vizuale dhe kreativiteti”, (The visual arts and creativity), www.alb-ahkenca.org, (2012).

Lulzime Leka – Mulaku
 Universiteti Shtetëror i Tetovës
 Tetovë, MACEDONIA

- Punimi shkencor: “The significance of the visual-figurative art in the development of children’s upbringing and creativity”, (2011).

www.ijser.com

Author: Lulzime Leka – Mulaku,
 State University of Tetovo – R e Maqedonisë,

- Punimi shkencor: “The significance of the visual-figurative art in the development of children’s upbringing and creativity”, (2012).

www.ijser.com

Author: Lulzime Leka – Mulaku,
 State University of Tetovo – Macedonia

GJUHËT E HUAJA DHE SHKATHTËSITË:

Profesor Inordinar, Dr. Lulzime Leka - Mulaku është njohëse edhe e disa gjuhëve. Ajo është njohëse e Gjuhës Angleze, Gjuhës Serbo-Kroate, Gjuhës Maqedonase, Gjuhës Boshnjake. Përpos aftësive gjuhësore, kandidatja posedon edhe aftësi dhe shkathtësi kompjuterike. Është plotësisht e familjarizuar me aplikacionet e Microsoft word-it: Excel-in, Word-in, Power point-in, PhotoShoop-in e tj. poashtu, i njeh aplikacionet për punë në rrjetin e internetit.

Prof. Inordinar, Dr. Lulzime Leka - Mulaku, shquhet për punën e saj si mësimdhënëse në Programin studimor: Art Figurativ të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Tetovës. Ajo është pedagoge shumë e çmuar në punën me studentët. Ajo është ligjëruese e aftë, e shkathët, praktike dhe e shquar me dhuntinë e sistemit dhe thjeshtimit të lëndës mësimore që ajo ligjeron, të paraqitjes së qartë dhe strukturimit të mendimeve, të argumentimit të bindshëm të pohimeve. Gjatë ligjëratave të saj vjen në shprehje përvoja, dija, kultura dhe formimi i saj, informimi i plotë qoftë edhe për të dhënat më të reja që kanë të bëjnë me lëndët, me të cilat merret dhe të cilat i ligjeron.

Përpos në punën e saj si pedagoge, krijuese - piktore tanimë me identitet të formuar artistik, kandidatja është aktive edhe në fushën kërkimore-shkencore në Shkencat mbi Artet.

Punimi i Disertacionit “Ndikimet e materialeve dhe teknikave në kreativitetin e të shprehurit figurative të fëmijëve nga klasa e V deri në të VIII”, është një kontribut i veçantë në fushën e Shkencave mbi Artet. Publikimet në revistat ndërkombëtare dhe ato kombëtare, po ashtu janë të rëndësishme për zhvillimet shkencore në këtë fushë.

Mbështetur në autorizimin e këtij komisioni recensues, mbështetur në parashtrimet më lartë, komisioni në vijim jep këtë mendim – propozim:

MENDIM DHE PROPOZIM

Duke pasur parasysh përvojën e saj profesionale, veprimtarinë në fushën artistike, punën si mësimdhënëse dhe vlerësimet pozitive të paraqitura në këtë referat, Komisioni recensues konsideron se kandidatja **Profesor inordinar, Dr. Lulzime Leka – Mulaku**, i plotëson të gjitha kriteret shkencore/ artistike e profesionale për t'u zgjedhur në thirrjen mësimore – shkencore **Profesor ordinar** për lëndët:

- METODIKË E EDUKATËS FIGURATIVE
- PIKTURË DHE TEKNIKA TË PIKTURËS,

(60708, 60701 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)

Fakulteti i Arteve,

programi studimor: Arti Figurativ.

Kemi kënaqësinë që me bindje të plotë t'i rekomandojmë Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës, që ta aprovoj mendimin e shprehur përmes këtij referati dhe të veprojë në pajtim me normat ligjore.

Tetovë, 31.05.2023

Anëtarët e komisionit recensues:

1. Prof. Dr. Fehim Husković—*prof. ordinar (kryetar)*-----

2. Prof. Ord. Mr. Reshat Ahmeti —*prof. ordinar (anëtar)*-----

3. Prof. Ord. Mr. Bashkim Mexhiti—*prof. ordinar (anëtar)* -----

FORMULARI 1

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË, MËSIMOR-PROFESIONAL DHE BASHKËPUNËTORË

Kandidati:

Lulzime Leka Mulaku

Institucioni:

Fakulteti i Arteve, Universiteti i Tetovës

Lëmia shkencore:

Metodika e edukatës figurative, Pikturë dhe teknika të pikturës (60708, 60701 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
1	Studime pasdiplomike të kryera dhe shkalla e arritur akademike: Magjistër i arteve figurative - pikturë. Sfera shkencore: Shkencat humane (6), Fusha shkencore: Arti figurativ (607), Lëmia shkencore: Metodika e edukatës figurative, Pikturë dhe teknika të pikturës (60708, 60701 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit),	po
2	USA, New York, Galeria e QKI, Maj 2018 Bursa, Republika e Turqisë, galeria e qytetit, Maj 2021. Pogradec, Republika e Shqipërisë, Galeria e Qytetit, Shtator 2022	po
3	Posedon aftësi për realizimin e punës mësimore 1. Emri i institucionit ku janë fituar aftësitë dhe shkathtësitë për realizimin e punës mësimore: Fakulteti i Arteve, Universiteti i Tetovës 2. Lloji i trajnimit/ përvojës/ arsimimit për përfitimin e aftësive dhe shkathtësive për realizimin e punës mësimore: Asistent, docent, profesor inordinar 3. Periudha e fitimit të aftësive dhe shkathtësive për realizimin e punës mësimore: 2004–2023	po

SH T O J C Ë

PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN
MËSIMORE-SHKENCORE, SHKENCORE DHE
MËSIMORE-PROFESIONALE

Kandidati: Lulzime Leka-Mulaku
Institucioni: Fakulteti i Arteve–UT, Tetovë

Lëmia shkencore:

Metodika e edukatës figurative, Pikturë dhe teknika të pikturës (60708, 60701 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)

Veprimtaria Mësimore-Arsimore				
Nr.	Veprimtaria			Poenat
1	Mbajtja e mësimdhënies (Ligjërata dhe Ushtrime)			38.40
	Viti Studimor	Semestri	Lëndët Mësimore	
	2018/19; ... ; 2022/23	Dimëror	Metodika1	
			Piktura 1	
			Arti Konceptual 1	
	Veror	Metodika2		
		Arti Konceptual 2		
Piktura 2				
2	Konsultime me studentë			5.40
	Viti Studimor	Semestri	Lëndët Mësimore	
	2018/19; ... ; 2022/23	Dimëror	Metodika1	
			Piktura 1	
			Arti Konceptual 1	
	Veror	Metodika2		
		Arti Konceptual 2		
Piktura 2				
3	Mësimdhënia në shkolla ose punëtori/organizim dhe pjesëmarrje			7.50
4	Përgatitja e një Lënde të re / ligjërata dhe ushtrime			3.00
6	Skripta interne nga ligjëratat			0.00
7	Paket materialesh për Lëndën e caktuar			2.00
Nr. i përgjithshëm i poenave				56.30

Veprimtaria Shkencore-Hulumtuese		
Nr.	Veprimtaria	Poenat
1	Mbrojtja e Temës së Doktoraturës; “Ndikimet e materialeve dhe teknikave në kreativitetin e të shprehurit figurativ të fëmijëve nga klasa e V deri në të VIII”, me Mentor, Prof. Dr. Fehim Husković.	
2	Punime me rezultate origjinale të publikuar në një revistë me këshill redaktues ndërkombëtar (2x6)	
3	Simpozium Ndërkombëtar Artistik (3x 6)	18.00
Nr. i përgjithshëm i poenave		18.00

Veprimtaria Profesionale-Artistike		
Nr.	Veprimtaria	Poenat
1	Paraqitje ndërkombëtare me veprimtari figurative (3x7)(vitet2018/2023)	21.00
2	Ekspozite Kolektive UT, Tetovë (8 x 2) (vitet2018/2023)	16.00
Nr. i përgjithshëm i poenave		37.00

Veprimtaria Mësimore-Arsimore	56
Veprimtaria Shkencore-Hulumtuese	18
Veprimtaria Profesionale-Artistike	37
Veprimtaria Profesionale-Aplikative	

Totali i poenave 111

Anëtarë të Komisionit recensues:

1. Prof. Dr.FehimHusković-
Profesor Ordinar (kryetar)

2. Prof.Mr.ReshatAhmeti -
ProfesorOrdinar (anëtar)

3. Prof.Mr.Bashkim Mexhiti –
Profesor Ordinar (anëtar)

Drejtuar:

**KËSHILLIT MËSIMOR-SHKENCOR TË FAKULTETIT TË ARTEVE
TË UNIVERSITET TË TETOVËS**

REFERAT

Për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Arti i klasicizmit të përgjithshëm, Arti i klasicizmit nacional, Arti i romantizmit të përgjithshëm, Arti i romantizmit nacional, Arti i realizmit të përgjithshëm, Arti i realizmit nacional, Arti i shekullit XX (impresionizmi, fovizmi, kubizmi, surrelizmi, dadaizmi) (60609, 60610, 60611, 60612, 60613, 60614, 60615 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në Programin studimor - Arti figurativ në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës

Në bazë të konkursit të datës 06.05.2023, të shpallur në gazetata ditore „Koha” dhe „Слободен печат”, si dhe në web faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, www.unite.edu.mk, për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin **Arti i klasicizmit të përgjithshëm, Arti i klasicizmit nacional, Arti i romantizmit të përgjithshëm, Arti i romantizmit nacional, Arti i realizmit të përgjithshëm, Arti i realizmit nacional, Arti i shekullit XX (impresionizmi, fovizmi, kubizmi, surrelizmi, dadaizmi) (60609, 60610, 60611, 60612, 60613, 60614, 60615 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)** në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës me Vendim të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Arteve me nr. 20-84/4 të datës 22.05.2023, u formua Komisioni recensues në përbërje:

1. Dr. **Nebojsha Viliq**, profesor ordinar në Fakultetin e Artit Dramatik, pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodij” në Shkup - **(kryetar)**
2. Mr. **Xhelil Rufati**, profesor ordinar në Fakultetin e Arteve pranë Universitetit të Tetovës - **(anëtar)**
3. Dr. **Metin Izeti**, profesor ordinar në Fakultetin e Arteve pranë Universitetit të Tetovës - **(anëtar)**

Komisioni recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në lidhje me konkursin e lartpërmendur dhe në përputhje me nenin 166, 167 dhe 172 të Ligjit për Arsim të Lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018” dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 178/2021”), Statutin e Universitetit të Tetovës, si dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, i paraqet Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Arteve dhe Senatit të Universitetit të Tetovës këtë:

RAPORT

Në konkursin e shpallur më datë 06.05.2023, në gazetat ditore „Koha” dhe „Слободен печат”, si dhe në web-faqen e Universitetit të Tetovës, për zgjedhjen e një mësimdhënësi në thirrjen - *profesor ordinar* në lëmin: **Arti i klasicizmit të përgjithshëm, Arti i klasicizmit nacional, Arti i romantizmit të përgjithshëm, Arti i romantizmit nacional, Arti i realizmit të përgjithshëm, Arti i realizmit nacional, Arti i shekullit XX (impresionizmi, fovizmi, kubizmi, surrelizmi, dadaizmi) (60609, 60610, 60611, 60612, 60613, 60614, 60615 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)** në Fakultetin e Arteve pranë Universitetit të Tetovës, u paraqit vetëm kandidati, Prof. Inord, Dr. Mixhait Pollozhani

Dokumentet e dorëzuara

- Diplomë për kryerjen e studimeve akademike (noterizuar)
- Diplomë për kryerjen e studimeve të magjistraturës (noterizuar)
- Vendim për thirrje mësimore-shkencore profesor inordinar (noterizuar)
- Listën e aktiviteteve profesionale-artistike dhe aplikative prej zgjedhjes së fundit në thirrje
- Biografinë ku mund të konstatohet kontinuiteti i studimeve dhe aktivitetet permanente profesionale artistike
- Punimin e doktoranturës
- Certifikatë për njohjen e gjuhës së angleze
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve
- Certifikatë e shtetësisë
- Fletaplikim nga Universiteti i Tetovës
- Kopje të artikujve dhe librave shkencor të publikuara brenda dhe jashtë vendit

II. BIOGRAFI E SHKURTËR

a. Arsimimi

Nga dokumentacioni i parashtruar u konstatua se, Prof. Inord, Dr. Mixhait (Mustafa) Pollozhani të është i lindur më 25 dhjetor 1958 në Strugë. Adr. Risto Krle, 3/3/2 – Strugë. Shkollën fillore e kreu në Livadhi dhe Dollogozhdë (komuna e Strugës), kurse të mesmen në (gjimnazin) në Strugës.

Ka diplomuar në degën e Historisë së Artit dhe Arkeologjisë pranë Fakultetit Filozofik të Universitetit “Shën. Kirili dhe Metodij” në Shkup.

Studimet pasuniversitare në vitin 2004 në Universitetin e Tiranës. Teza magjistraturës me titull: *“Monumentet të kultit paleokristian në Maqedoninë Perëndimore”*, mentor Dr. Skënder Muça, duke marrë titullin – Magjistër i Arkeologjisë. Në këtë punë të rëndësishme shkencore, e cila është në fazën e publikimit, autori merret me studimin e monumenteve të kultit paleokristiane, me theks të veçantë të vënë te bazilikat, ashtu që duke shfrytëzuar 137 referenca bibliografike në mënyrë profesionale dhe shkencore i ka grumbulluar dhe i ka prezantuar monumentet më të rëndësishme në trevat perëndimore të Maqedonisë.

Disertacionin e Doktoranturës të titulluar *“Realizmi socialist (1945-1950) në artin figurativ në Jugosllavi, Shqipëri dhe Bullgari”* e mbrojti në muaji janar të vitit 2011, në Institutin e historisë si artit dhe arkeologjisë të Fakultetit Filozofik pranë Universitetin “Shën Kirili dhe Metodij” në Shkup. Ky punim (akoma i pa publikuar) paraqet veprën e vetme shkencore kushtuar kësaj problematike specifike të artit figurativ. Edhe pse në titullin e punimit, i përbërë nga 454 faqe, bëhet fjalë për një periudhë kohore 1945 – 1950, megjithatë brenda tij është përfshirë periudha e cila vazhdoi pothuajse gjysmën e shekullit XX, që paraqet një fazë tejet të rëndësishme të historisë së artit modern. Punimi i disertacionit të doktoranturës, i cili, në veçanti apo dhe në mënyrë krahasuese e studion këtë periudhë në artin modernë nëpërmjet elementeve të ngjashme apo dhe të ndryshme të shprehura gjatë viteve të fundit në tri vendet fqinje. Janë bërë hulumtime të gjera të veprave karakteristike dhe relevante figurative, si dhe të materialeve të shkruara mbi këtë problematikë, duke shkoqitur elementet dhe përfundimet thelbësore. Janë konstatuar lidhje të ndjeshme midis diktatit politik dhe krijimtarisë së kësaj periudhe historike, veçanërisht duke vënë theksin te veprat artistike që janë rezultat i atyre marrëdhënieve specifike. Si rezultat i analizës profesionale dhe shkencore, si dhe metoda e zbatuar në përgatitjen e punimit shkencor, i cili paraqet një përpjekje pioniere në trajtimin e një materie të këtillë specifike, konceptualisht është ndërtuar si një projeksion integral të trajtimit dhe interpretimit të periudhës së realizmit socialist nëpërmjet krijimtarisë artistike, e krijuar sipas principeve të ideologjisë komuniste, që në thelb paraqet një problematik specifike artistike. Punimi përbëhet nga pjesa e përgjithshme dhe pjesa kryesore, të cilët pastaj janë ndarë në më shumë kapituj dhe nënkapituj, i trajton faktorët historik, filozofik, ideologji dhe politik, karakteristikat vizuale dhe estetike, të cilat

ndihmuan në formimin konceptual të doktrinës artistike të socrealiste. Për të theksuar është pasqyrim i krijimtarisë socrealiste figurative të kapitullit të tretë, ku janë prezantuar pothuajse të gjitha momentet dhe veprat më të rëndësishme, të kushtëzuara nga ndodhitë politike nëpër të cilat kaluan shoqëritë komuniste në Jugosllavi, Shqipëri dhe Bullgari.

b. Aktiviteti akademik

Kandidati, Prof. Inord, Dr. **Mixhait Pollozhani** nga viti shkollor 2004/5 është i punësuar në Universitetin Shtetëror të Tetovës, asistent dhe pastaj ligjërues i lëndëve Historia e Artit në Fakultetin e Arteve dhe lëndën Trashëgimia kulturore e në Fakultetin Ekonomik të këtij universiteti. Në vitin shkollor 2010/2011 me vendim të Këshillit mësimor – shkencor të FA dhe Këshillit të Rektoratit të USHT – së, Mr. Mixhait Pollozhani i zgjedh asistent në Fakultetin e arteve pranë USHT – së në fushën e historisë së artit. Me vendim të Këshillit mësimor – shkencor të FA dhe Këshillit të Rektoratit të USHT – së, kandidati dr. Mixhait Pollozhani më datë 05. 06. 2013 është zgjedhur në thirrjen mësimore *docent* në Fakultetin arteve të Universitetit shtetëror të Tetovës, për lëndën Historia e artit 5, 6, 7 dhe 8 në Programin studimor të Artit figurativ. Me vendim të Këshillit mësimor – shkencor të FA dhe Këshillit të Rektoratit të USHT – së, kandidati dr. Mixhait Pollozhani është zgjedhur profesor inordinar për lëndët: Historia e artit 5, Historia e artit 6, Historia e artit – shek. XX dhe Historia e artit postmodern. Që nga momenti i zgjedhjes në titullin akademik – *docent*, kandidati Mixhait Pollozhani, rregullisht ligjeron në të dy semestrat të çdo viti shkollor, në ciklin e parë dhe të dytë të Fakultetit të Arteve.

Kandidati, Mixhait Pollozhani në ciklin e dytë të studimeve është i angazhuar si mësimdhënës për lëndën: **Poetika e artit I dhe II.**

Aktiviteti mësimor e Prof. Inord, Dr. Mixhait Pollozhanit, krahas në fakultetin amë disa vite me radhë, deri në vitin akademik 2016/2017, e ka ligjëruar lëndën Trashëgimia kulturore në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës.

Kandidati, Prof, Inord, Dr. Mixhait Pollozhani është zgjedhur kryetar dhe anëtar i komisioneve për vlerësimin dhe mbrojtjen e punimit të diplomës të pesë kandidatëve në studimet master dhe tre kandidatëve në studimet deridiplomike.

c. Aktivitet tjera

Gjithashtu vërejtëm se aktiviteti i tij pedagogjik fillon që më herët, më saktë, në vitin 1988 kur punoi si profesor në Shkollën e Mesme ‘Muharrem Bekteshi’ në Vuçitërnë të Kosovës, ku ligjëronte lëndën Historia e artit. Një fazë shumë të rëndësishme në punën krijuese të Mixhait

Pollozhani paraqet publicistika, duke nënvizuar se që nga vitit 1992 deri në vitin 2004 punoi për gazetën e përditshme Flaka në kuadër të NGB “Nova Makedonija” të Shkupit.

Prof. Inord, Dr. Mixhait Pollozhani drejtoi edhe projektin ‘Për një Strugë më të bukur’, vështrim, SHAK ‘A – 3’, Strugë, maj, 2002, pastaj me koloninë artistike ‘Struga 2005’, vështrim, SHAK ‘A – 3’, Strugë, shtator, 2005; Projekti “Art dhe mirëkuptim” m studentët e Fakultetit të shkencave të zbatuara të Universitetit të Tetovës u realizua në Strugë dhe Ohër në vitin 2016, etj.

Prof. Inord. Dr. Mixhait Pollozhani për 23 vite me radhë e drejton **Shoqatën për art dhe kulturë “A-3** me seli në Strugë, duke e thelluar interesin dhe angazhimin e tij në lëmin e artit figurativ. Si rezultat pasuan me dhjeta ekspozita të organizuara, me ç’rast kandidati ka bërë punën e kuratorit dhe ka shkruar vështrimet të shumta për katalogët e publikuara. Në kuadër të aktivitetit të kësaj shoqate duhet veçuar ekspozitën e absolventëve të Fakultetit të Arteve në Universitetin e Tetovës, aktivitet ky i cili mbahet për çdo vit në qytetin e Strugës, duke u mundësuar kështu studentëve që të përballen me tërë procesin krijues dhe prezantues para publikut. Vetë absolventët merren me realizimin, seleksionimin dhe fotografimin e punimeve, me tekstin dhe përgatitjen e katalogut bashkë me materialin përcjellës propagandistik, siç janë posteri dhe ftesat dhe me aranzhimi i ekspozitës.

Gjithashtu do të theksojmë se në kuadër të këtyre mundësive, kandidati Pollozhani, krahas punëve të përditshme informative publikoi shumë kontribute profesionale nga fusha e arkeologjisë dhe historisë së artit në gazetatat dhe revistat: “Flaka”, “Faktit”, “Lajm”, “Shenja”, “Drini” - (Shkup – Strugë), “Rilindja”, “Fjala”, “Bota Sot” - (Prishtinë), pastaj revistat: “Jehona”, “Drini”, “Universitas”, “Shenja”, etj.

II. VEPRIMTARIA SHKENCORE - HULUMETUESE

Kandidati Prof. Inord. Dr. Mixhait Pollozhani, ka reguar interes dhe angazhim të vazhdueshëm në veprimtarinë e tij kërkimore-shkencore. Në periudhën pesëvjeçare ndërmjet dy zgjedhjeve, kandidati ka marrë pjesë në tubime shkencore ndërkombëtare dhe ka botuar punime dhe tekste në disa revista shkencore dhe popullore brenda dhe jashtë vendit. Intensiteti i veprimtarisë së tij kërkimore-shkencore në fushën e historisë së artit në periudhën 2013-2018, kur realizoi disa projekte, vazhdoi edhe për pesë vitet e ardhshme. Si rezultat i angazhimit të tij në fushën e historisë së artit gjatë periudhës 2018-2023, pasuan një numër i madh kritikash, recensionesh dhe kontributesh, kryesisht nga fusha e arteve figurative në planin kombëtar shqiptar, por duke përfshirë edhe disa ngjarje nga artet pamor në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ndër ato i veçuem kontributet e mëposhtme:

Pollozhani, Mixhait, *The beginnings of Albanian fine art in the Republic of North Macedonia*, chrome extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://eprints.unite.edu.mk/648/1/12.pdf

Hasani Jelldes, Pollozhani Mixhait, *Albanien vizual arts ad new Technologies: Interactive ana aesthetic challenges*, 7th International Conference of the Faculty of Philosophy ISCFPH22, “Socio-cultural issues: Approaches and opportunities in the past and today”

Të një rëndësi të veçantë janë dhe një mori artikujsh, recensionesh, vështrimesh të cilët janë kushtuar veprimtarisë figurative të artistëve më të njohur shqiptar në Maqedoni dhe jashtë saj. Dominojnë kontributet e botuara në revistën në gjuhën shqipe “Shenja” e cila botohet në Shkup, siç janë:

- “Peneli i gjuhës (pan)ekspresioniste e piktores Lulzime Leka”
- “Historia e një skulpture – Skënderbeu i Kërçovës”
- “Skulpturat e Paskalit edhe në Maqedoni”
- “Bejkon-i inspirohej nga Izet Curi”
- “Një studim i munguar mbi pikturën islame”
- “Omer Kaleshi një (post)surrealist bashkëkohor”
- “Nevzat Kica – “Blurajderi” i ekspresionizmit shqiptar
- “Censura blu mbi imazhin e kuq”
- “Portrete të koduara me gjuhë konceptuale të Miftar Memetit”
- “Rexhai Iseni – Kubisti i shpateve të Karadaku”
- “Pikturimi i ndërthurjeve (post)moderniste e piktores Bukurie Oseku – Dalladaku”
- “Reshat Ameti – Avangardisti përtej gjeometrizmit lirik”
- “Murat Toptani, themelues i skulpturës shqiptare” “Pavarësitë e metalta shqiptare”
- “Konceptime moderne dhe multimediale” “Shkupi 2014 - projekt me elemente soc-realiste”
- “Përvjetori pa Ibrahim Kodrën, - I pari kubist shqiptar dhe i fundit post-kubist botëror”;
- “Figura e Skënderbeut në artet pamore, materializim i nduarduar stilistik dhe ideestetik”;
- “Piktura e Zake Prelvukajt, Reflektim i fuqisë artistike”;
- “Një identitet artistik dhe Pavarësia”;
- “Përvojat”;
- “Një histori në dy koncepte”;
- “Pavarësitë e metalta shqiptare”;
- “Integrimi i manifestuar në bronz”;
- ““Bludrajdëri” i ekspresionizmit shqiptar”;
- ““Nëna shqiptare” kujtesë e (pa)harruar!”;
- “Omer Kaleshi një (post)surrealisti bashkëkohor” etj.

Por megjithatë, theksin kryesor të veprimtarisë shkencore – hulumtuese Prof. Inord. Dr. Mixhait Pollozhani gjatë pesëvjeçarit të kaluar e ka vënë në përfundimin të disa projekteve shumëvjeçare, që rezultuan me publikimin e pesë librave të cilat janë me karakter monografik dhe jubilar të shkruara në gjuhën shqipe, maqedonase dhe me rezyme në anglisht. Tre prej tyre kanë të bëjnë

me jetën dhe krijimtarinë e piktorëve më të njohur shqiptar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe ato janë: **Adem Kastrati, Rexhai Hyseni dhe Reshat Ameti.**

Prof. Inordinar Dr. Mixhait Pollozhani, e autor i librit kushtuar piktorit Adem Kastrati, i publikuar në vitin 2018, me rastin e 85 vjetorit të lindje së piktorit në fjalë, si dhe me rastin e 70 vjetorit të themelimit të Ik Galerisë Kombëtare të Maqedonisë e botuar nga institucioni i njëjtë. Krijimtarinë dyzetvjeçare të këtij piktori, autori në fjalë e ka ndarë katër faza: *Faza e krijimtarisë së hershme* (1958 – 1962); *Faza e konsolidimit të pikturimit me ngjyra dheu* (1962 – 1968); *Faza e dëshimit artistik në planin (ndër)kombëtar* (1968 – 1988); *Faza e kompozicionit të dramës kombëtare* (1988 – 2000). Por për më shumë opusi i gjerë i tij krijues u manifestua nëpërmjet stileve (rrymave) të cilat shfaqen herë si të veçanta dhe herë të ndërthurura njëra me tjetrën.; Opusi e tij i gjerë krijues u manifestua përmes një sërë stiles (drejtimesh) artistike që herë duken të ndara e herë të ndërthurura me njëra-tjetrën, prej të cilave autori i librit vuri në pah tre grupe stilistike, përkatësisht: gjuhën e sintetizuar stilistike, shprehjen stilistike ekspresive - ekspresioniste dhe realizmin fantastik. dhe stilin (post)surrealist.

Në librin kushtuar piktorit Rexhai Hyseni (1939), botuar në vitin 2019, me rastin e 80-vjetorit të lindjes së këtij piktori, autori dr. Mixhait Pollozhani si më të pranueshme ka zgjedhur ndarjen e kombinuar kronologjike dhe stilistike të krijimtarisë së tij piktorit në fjalë. Ndaj dhe për këtë arsye, krijimtarinë e Rexhai Hysenit e ka grupuar në tre variante stilistike, të cilat janë: *Varianti i figuracionit ekspresiv dhe realist* (1963 – 1980); *Varianti i poetikës kubo-surrealiste* (1968 – 1995); *Varianti i sintezës neo-kubiste* (1969 – 2003). Këto variante bashkë me disa nënvariate tjera e begatojnë edhe e shprehin karakterin heterogjen të poetikës së krijimtarisë së Rexhai Hysenit.

Dr. Mixhait Pollozhani, në vitin 2020, me rastin e 30-vjetorit publikoi monografinë kushtuar jetës dhe krijimtarisë së Reshat Ametit. Autori i librit ka vënë në pah tematizimin, hulumtimin dhe diskutimin e traditës folklorike dhe modernizmin në pikturën Amethi. Duke ndërthurur abstraksionin figural dhe asociativ, Reshat Ameti pasuron dorëshkrimin e tij piktorial, i cili kryesisht lëviz në kuadrin e abstraksionit gjeometrik dhe abstraksionit lirik. Kështu që, ndërsa njëra linjë e krijimtarisë së tij shkon në drejtim të gjeometrisë lirike të stilizuar, tjetra shkon në drejtim të abstraksionit lirik koloristik, ku përfshihen edhe një sërë (nën)variantesh të tjera stilistike, thekson autori, Dr. Pollozhani.

Në monografinë me titull “*Draudacum, Njëzet vjet art*”, kushtuar aktivitetit të shoqatës së artistëve figurativ shqiptarë me qendër në Gostivar, botuar në vitin 2019, Dr. Mixhait Pollozhani pasqyron organizimin e ekspozitave të shumta të artit figurativ, grupe dhe individual, si një aktivitet kryesor artistik, pastaj organizimin e kolonive artistike dhe aktiviteteve të tjera me karakter konkurrues në fushën e arteve figurative. Sipas informacioneve që sjellë ky libër, bërthamën thelbësore të aktiviteteve të ekspozitës dhe shumëllojshmëria e mediave të artit të bukur e përbëjnë: piktura, skulptura, vizatimi, grafika, fotografia, arti i aplikuar (dizajni) dhe shumë rrallë një mostër e instalimeve artistike dhe veprave konceptuale..

Krahas “*Mozaik Arkeologjik*” botuar nga redaksia e botimeve Flaka më 2001, Mixhait Pollozhani, në vitin 2018 ka publikuar edhe librin dytë nga fusha e trashëgimisë kulture, me titull

“*Monumente të kultit palekristian në Maqedoninë Perëndimore*”, të botuar nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, i cili është versioni i punimit të magjistraturës i plotësuar edhe me rezultate të reja shkencore.

Në periudhën 2018 – 2023, kandidati Docent dr. Mixhait Pollozhani ka marrë pjesë në dy kongreset shkencore të organizuar nga Universiteti i Tetovës:

PËRFUNDIM DHE PROPOZIM

Në bazë të konstatimeve të lartpërmendura, duke vlerësuar pozitivisht aktivitetin në veprimtarinë edukative-mësimore, profesionale-artistike dhe aplikative, veprimtarinë me interes më të gjerë, vazhdimësinë në studime, përvojën pedagogjike dhe universitare prej zgjedhjes në thirrjen asistent, docent, profesor inordinar në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës dhe sipas Ligjit për Arsim të Lartë, Statutit të Universitetit të Tetovës dhe Rregullores për kriteret e veçanta dhe procedurën për zgjedhje-rizgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë, mësimorë-profesionalë dhe bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës, Komisioni recensues vlerëson se kandidati **Prof. Inord. Dr. Mixhait Pollozhani** i plotëson të gjitha kushtet e nevojshme për zgjedhje në thirrjen mësimore-profesionale **Profesor Ordinar**.

Komisioni Recensues ka nderin t’i propozoj Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Arteve dhe Senatit të Universitetit të Tetovës, që kandidati **Prof. Inord. Dr. Mixhait Pollozhani** të zgjidhet në thirrjen mësimore-profesionale **Profesor Ordinar** në lëmin **Arti i klasicizmit të përgjithshëm, Arti i klasicizmit nacional, Arti i romantizmit të përgjithshëm, Arti i romantizmit nacional, Arti i realizmit të përgjithshëm, Arti i realizmit nacional, Arti i shekullit XX (impresionizmi, fovizmi, kubizmi, surrelizmi, dadaizmi) (60609, 60610, 60611, 60612, 60613, 60614, 60615 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)** në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës.

Anëtarët të Komisionit

Prof. Ordinar Dr. **Nebojsa Viliq**, (kryetar)

Prof. Ordinar Mr. **Xhelil Rufati**, (anëtar)

Prof. Ordinar Dr. **Metin Izeti**, (anëtar)

Tetovë, 12. 06. 2023

FORMULARI 1

KUSHTET E PËRGJITHËSHME PËR ZGJEDHJEN NË TITUJT MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË, MËSIMORË-PROFESIONAL DHE BASHKËPUNËTORË

Kandidati: **Prof. Inord. Dr. Mixhait (Mustafa) Pollozhani**
Institucioni: **Fakulteti i Arteve - Universiteti i Tetovës**
Lëmia: **Arti i klasicizmit të përgjithshëm, Arti i klasicizmit nacional, Arti i romantizmit të përgjithshëm, Arti i romantizmit nacional, Arti i realizmit të përgjithshëm, Arti i realizmit nacional, Arti i shekullit XX (impresionizmi, fovizmi, kubizmi, surrelizmi, dadaizmi) (60609, 60610, 60611, 60612, 60613, 60614, 60615 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITULL MËSIMOR-SHKENCOR-PROFESOR ORDINAR

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
1	Titull shkencor: - Doktor i Historisë së Artit Emri i sferës shkencore: Historia e Artit (shekulli XIX, XX, XXI)	Po
	Të ketë të publikuara së paku 6 (gjashtë) punime shkencore të recensuara në pube likime shkencore referente në pajtim me Ligjin për arsimin e lartë në pesë vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhje – rizgjedhje 1.1 Revista: International Journal of Social and Human Sciences <i>The beginnings of Albanian fine art in the Republic of North Macedonia</i> , chrome extension://efaidnbmnnnibpcajpcgiclfefindmkaj /https://eprints.unite.edu.mk/648/1/12.pdf Tetovë, 2020 1.2 Revista: International Journal of Social and Human Sciences <i>Albanien vizual arts ad new Technologies: Interactive ana aesthetic challenges</i> , 7 th International Conference of the Faculty of Philosophy ISCFPH22, “Socio-cultural issues: Approaches and opportunities in the past and today” Tetovë, 2023	Po

	<p>1.3 Revista Shenja nr. 70, f. 81 - 84, <i>Omer Kaleshi një (post)surrealist bashkëkohor</i>, Shenja, f. 81 - 84, Shkup, 2017</p> <p>1.4. Revista Shenja nr. 72, f. 93 - 96, <i>Bejkoni inspirohej nga Izet Curi</i>, Shkup, 2017</p> <p>1.5 New Archeological Discoveries in the Albanian Regions, Academy for Albanien Studies, Institute of Archeology, 30 – 31 januari, Volume I, Botime Albanologjike, <i>The Typology of Illyrian Helmets in the Macedonia International Conference</i>, Tirana 2017</p>	
--	---	--

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
3	<p>Libri ose pjesa e librit të recensuar dhe publikuar në shtetin anëtar të Bashkimit Evropian / ose OBZHE</p> <p>Libër: <i>Monumente të kultit palekristian në Maqedoninë Perëndimore</i>, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, Shkup, 2018</p> <p>Monografi: <i>Adem Kastrati</i>, Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2018</p> <p>Monografi: <i>Rexhai Hyseni</i>, Shkup, 2019</p> <p>Monografi: <i>Draudacum, Njëzet vjet art</i>”, Gostivar, 2019</p> <p>Monografi: <i>Reshat Ameti</i>, Strugë, 2020</p>	Po
4	<p>Zgjedhja e mëhershme në titullin mësimor-shkencor– profesor i asociuar, data dhe numri i Buletinit: Profesor Inordinar 05. 05. 2018, Buletini nr. 129</p>	Po
5		

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
	<p>Posedon aftësi për realizimin e veprimtarisë në arsimin e lartë:</p> <p>1. Emri i institucionit ku janë fituar aftësitë dhe shkathtësitë për ushtrimin e veprimtarisë në arsimin e lartë:</p> <p>Fakulteti i Arteve – Universiteti i Tetovës</p> <p>2. Lloji i trajnimit/ përvoja/ arsimimi për fitimin e aftësive dhe shkathtësive për realizimin e veprimtarisë në arsimin e lartë:</p> <p>Asistent, Docent, Profesor Inordinar</p> <p>3. Periudha e fitimit të aftësive dhe shkathtësive për realizimin e veprimtarisë në arsimin e lartë:</p> <p>(2004 - 2018)</p>	
	<p>Njohja e të paktën një gjuhe të huaj, e përcaktuar me akt të përgjithshëm të universitetit, d.m.th. një shkollë e lartë Profesionale e pavarur.</p> <p>Gjuha e huaj: Gjuha italiane</p> <p>Emri i dokumentit: Certifikatë</p>	Po

FORMULARI 2

PËR RAPORTIN E ZGJEDHJES NË TITUJ MËSIMORE-SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONAL

Kandidati: **Prof. dr. Mixhait (Mustafa) Pollozhani**

Institucioni: **Fakulteti i Arteve - Universiteti i Tetovës**

Lëmia: **Arti i klasicizmit të përgjithshëm, Arti i klasicizmit nacional, Arti i romantizmit të përgjithshëm, Arti i romantizmit nacional, Arti i realizmit të përgjithshëm, Arti i realizmit nacional, Arti i shekullit XX (impresionizmi, fovizmi, kubizmi, surrelizmi, dadaizmi) (60609, 60610, 60611, 60612, 60613, 60614, 60615 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**

VEPRIMTARIA EDUKATIVO-ARSIMORE

Nr. rend	Emërtimi i aktivitetit:	Pikët
1.	Mbajtja e ligjëratave të ciklit të parë të studimeve	
1.1.	Historia e Artit 5, 2+2, 5 semestra	4x15x5x0.04=12
1.2.	Historia e Artit 6, 2+2, 5 semestra	4x15x5x0.04=12
1.3.	Historia e Artit 7, 2+2, 5 semestra	4x15x 5x0.04=12
1.4.	Historia e Artit 8, 2+2, 5 semestra	4x15x5x0.04=12
2.	Mbajtja e ligjëratave të ciklit të parë të studimeve	
2.1	Historia e Artit 5, 1+1, 5 semestra	2x15x5x0.03=4.5
2.2	Historia e Artit 6, 1+1, 5 semestra	2x15x5x0.03=4.5
2.3	Historia e Artit – shek. XX, 1+1, 5 semestra	2x15x5x0.03=4.5
2.4	Historia e Artit Postmodern, 1+1, 5 semestra	2x15x5x0.03=4.5

3.	Mbajtja e ligjëratave (lëndët në ciklin e dytë të studimeve)	
3.1	Poetika e artit 1 (2+0)	2x15x1x0.05=1.5
3.2	Poetika e artit 2, (2+0)	2x15x1x0.05=1.5
4.	Konsultime me studentët	
4.1	Historia e Artit 5	30x5x0.002=3
4.2	Historia e Artit 6	30x5x0.002=3
4.3	Historia e Artit – shek. XX	30x5x0.002=3
4.4	Historia e Artit Postmodern	30x5x0.002=3
5.	Mësimi në terren	
5.1	Vizitë e galerive dhe muzeve	12x5x0.04=2.4
	Gjithsej	68.4

VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr. rend	Emërtimi i aktivitetit	Pikët
1.	Libra	
1.1	<i>Monumentet të kultit paleokristian në Maqedoninë Perëndimore</i> , ITKSH, Shkup, 2018	8
2.	Monografi	

2.1	<p>Pollozhani, Mixhait, <i>Monumente të kultit paleokristian në Maqedoninë Perëndimore</i>, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, Shkup, 2018</p> <p>Pollozhani, Mixhait, <i>Adem Kastrati</i>, Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2018</p> <p>Pollozhani, Mixhait, <i>Rexhai Hyseni</i>, Shkup, 2019</p> <p>Pollozhani, Mixhait, <i>Draudacum, Njëzet vjet art</i>”, Gostivar, 2019</p> <p>Pollozhani, Mixhait, <i>Reshat Ameti</i>, Strugë, 2020</p>	<p>8</p> <p>8</p> <p>8</p> <p>8</p> <p>8</p>
3.	Skripte interne për ligjerata	
3.1	Pollozhani, Mixhait, <i>Baroku</i> (Historia 5)	4
3.1	Pollozhani, Mixhait, <i>Rokoko dhe shekulli i XIX</i> (Historia 6)	4
3.1	Pollozhani, Mixhait, <i>Arti modern i gjysmës së parë të shekullit XX</i> (Historia e Artit 7)	4
3.1	Pollozhani, Mixhait, <i>Arti (post)modern dhe shekulli XXI</i> (Historia e artit 8)	4
4.	Konferenca dhe simpoziume shkencore vendore dhe ndërkombëtare	
3.1	Tubim ndërkombëtar shkencor: <i>Takimi i VIII Vjetor Ndërkombëtar të Institutit Alb-Shkenca</i> , Tiranë, 2013	4
3.2	Kongres shkencor ndërkombëtar: <i>International Congress of Albanian Archaeological Studies, Centre of Albanian Studies, Institute of Archeology</i> , Tiranë, 2014	4
	Konferencë shkencore ndërkombëtare: <i>International Conference, New Archeological Discoveries in the Albanian Regions</i> , Academy for Albanian Studies, Institute of Archeology, 30 – 31 januari, Tirana 2017	4
4.	Artikuj me rezultate origjinale shkencore/profesionale, të publikuara në konferenca ndërkombëtare në revista ndërkombëtare si dhe në revista me impakt faktor dhe me proceedings me bord redaktues ndërkombëtar	

4.1	Revistë shkencore ndërkombëtare: <i>“The Image Censorship Albanian Soc-realistic Painting”</i> , Interkulturalnost, Novi Sad, 2013	6
4.2	Revistë shkencore ndërkombëtare: <i>“Reincarnation of Soc-realism in the Project Skopje 2014”</i> Interkulturalnost, Novi Sad, 2014	6
4.3	<i>New archeological evidence from Uscana, Kicevo</i> , Proceedings of The International Congress of Albanian Archaeological Studies, 65 Anniversary of Albanian Archeology, 21-22 November, Tirana 2013), Centre of Albanian Studies, Institute of Archeology, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2014	6
